



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 111

Prishtinë, më 29.4.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina. Nijazi Idrizi, Boban Todorović, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 22.4.2013,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratet mjedisore,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.4.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22.4.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratet mjedisore

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin se grupi punues për këtë projektligj nuk ka pasur mundësi të vazhdoi punën për shkak se grupi i punës po ballafaqohet me vështirësi sa i përket kuorumit në rastet kur komisioni po punon në cilësinë e GP, ndaj sugjeroi që të punohet në numrin më të vogël në rastet e caktimit të grupeve punuese. Fillimisht u formua GP në përbërje :

Nait Hasani-kryesues, **Daut Haradinaj**, **Liburn Aliu** dhe **Salih Morina**, ndërkaq më tutje kryetari vazhdoi dhe ceku se me këtë projekt komisioni është mbrapa për shkak të ngarkesës me punë të Kuvendit të Kosovës me mbledhjet plenare etj. Në vazhdim **u kërkuan vërejtjet e të pranishmëve** lidhur me këtë projektligj të dërgohen deri sot një javë, në mënyrë që ato të shqyrtohen pastaj në GP.

4. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani në këtë pikë njoftoi si vijon :

- Projektligji për ndërtesat në bashkëpronësi ka kaluar në komisionet e përhershme përveç në Komisionin për Legjislacion i cili ka sugjeruar për mungesën e bazës juridike dhe mos miratimin nga komisioni funksional, ndaj pasi që disa anëtarë (**Nijazi Idrizi, Liburn Aliu**) kishin arsyetimin për të mbajtur një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Legjislacion për të sqaruar gjërat e kërkuara, komisioni vendosi që të mbahet mbledhja e përbashkët në ditët në vijim,
- Vizita në Shqipëri do të realizohet më 16 maj me mbështetjen e ZRRUK (nisja paradite ose pasdite varësisht nga mbledhja plenare) në Korçë, Voskopoj dhe Prespë, ku do të marrin pjesë përveç anëtarëve të komisionit dhe stafit nga Kuvendi, edhe zyrtar tjerë dhe ekspert, ku do të filloi draftimi i ligjit për Rregullatorin,
- Debati publik për Projektligjin e Planifikimit Hapësinor dhe Trajtimin të ndërtimeve pa leje mbahet në EMERALD më 7 maj 2013 sipas agjendës : shqyrtimi i një projekti paradite dhe tjetrës pasdite, ftesa dërgohet sot,
- Për ftesën nga Universiteti i Bujqësisë në Krakow, komisioni nuk u prononcua.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani